

JANIS KALPUZOS  
**IMARET**  
**NËN HIJEN E KULLËS SË SAHATIT**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



JANIS KALPUZOS

# IMARET

NËN HIJEN E KULLËS SË SAHATIT

roman

përktheu nga origjinali greqisht  
Kristo Pulla

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Autori: Γιάννης Καλπούζος (Janis Kalpuzos)  
Titulli në origjinal: Ιμαρέτ. Στη σκιά του ρολογιού  
Botoi në greqisht: Psichogios Publications S.A.



Me bashkëfinancimin e Programit  
“Europa Krijuese” të Komisionit European.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Albina Pulla

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Edona Marku

© e imazhit në kopertinë: Alban Xhafa

ISBN 978-9928-348-70-8

© 2015, Psichogios Publications S.A.

© në *shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)


[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

[www.toena.al](http://www.toena.al)

*“Në saje të lidhjeve shumë të ngushta shoqërore që u zhvilluan midis grekëve dhe otomanëve, këta të fundit e kishin humbur sjelljen prej pushtuesi, që e dallon zakonisht kombin sundues.”*

Spiridon Paganelis  
*SHËNIME UDHËTIMI*  
*Pushtimi ushtarak i Artës (1882)*

# Arta (1854-1882)



Imaret



Xhamia e Faik Pashës

LUMI ARAATHOS

Kanali i mullinjve me ujë

Jefropullo

LAGJA ELIJASBEJ

Kisha e Shën Gjergj Baxit

Kisha e Shën Theodorës

LAGJA E SHËN THEODHORËS

Kisha e Shpëtimtarit

Xhamia Feizul

Mulli

Xhami teqe

Varrezat turke

Mulli

Punishte ullinjsh

JETIKA

HAN

HAN

LAGJA PLATANOS

Shën Kostandini

Shën Minaj

LAGJA ALBAMARIA

ROMIOPAZARO

Pantokratori

Parigoritria

LAGJA MUHUSTI

Drejtim urës

Drejt kishës Odhijitria

Përrua

Përrua

Ham

E

Kisha e

Kisha e

Lluka

Kisha e S

Dhimitri

Kisha e Shën Spiridhonit

**MITROPOLIA**



LUMI ARAHTHOS

**KALAJA**  
(kështjella)

ARAHTHOS

Petrovuni

Drejt  
Manastirit Faneromeni,  
kazermë  
për mbrojtje

Drejt  
Anino  
Peta Kobotit

## *Emërtime në skicë*

1. Shkolla Femërore
2. Kafe “Aman”
3. “Jali Kafene”
4. Vila Karapano
5. Vila Varzeli (Nënkonsullata ruse)
6. Vila Dh. Andonopullu
7. Nënkonsullata greke
8. Shkolla Ndërdisciplinore
9. Shkollë Greke
10. Agjencia franceze
11. Spitali ushtarak - Komandatura
12. Vila Koboti - Xhandarmëria turke
13. Baikusi
14. Kulla e sahatit
15. Qendra “Qirici”
16. Evangjelistra
17. Sheshi dhe Rrapi
18. Sheshi i vogël me rrapin
19. Shkolla e Hebrenjve (Mizra)



## *Natën e 11 prillit 1854*

Sahati i kalasë - sahati më i vjetër mekanik me disk në të gjithë Perandorinë e pakufishme Otomane - kumboi duke shënuar orën e dytë të natës. Tingulli i kabanës së tij u derdh si një kumbim i ëmbël në veshët e Londos Thersitit. Tashmë i kishte lënë pas kodrat që i kishte kapërcyer njërën pas tjetrës, zbriti nga pela në të tatëpjetën me kalldrëm afër rrënojave të mullirit të vjetër me ujë, dhe duke hipur përsëri mbi kafshën e vet, po përshkonte me trok të lehtë atë vend të rrafshët që hapej përpara tij.

Duke i mbajtur të gjitha shqisat në gatishmëri, e drejtoi vështrimin për nga Arta, por pemët e larta të ullinjve përpara tij fshihnin edhe ato pak drita që kishte qyteti. Vetëm hëna po tregohej dorëlëshuar me dritën e saj, thua se donte t'i vinte në ndihmë apo të lehtësonte plagët e atij vendi të përvuajtur.

Tingulli i sahatit dhe drita e hënës bashkë me të, dukej sikur po e qetësonin shpirtin e tij. Por siç rezultoi më vonë, ishte një qetësi e rreme. Befas diçka kërciti, pela shkundi menjëherë kokën dhe ai vetë u mbulua me djersë të ftohta. I shqetësuar kthente kokën majtas dhe djathtas, ndërsa hijet e pemëve në sytë e tij merrnin forma nga më paradoksalet. I dukej sikur lëviznin, nxirrnin duart që ta rrëmbenin, ngrinin lart jataganët.

“Edhe gurin e varrit frika e shndërron në njeri”, iu kujtua një fjalë e urtë turke, teksa ajo zhurmë nuk u përsërit më dhe vetëm kërcitja ritmike e patkonjve thyente heshtjen e natës.

Londos Thersitis ishte tepër i shqetësuar. Nga njëra anë, për shkak të gjendjes shpërthyesë në atë rajon pas fillimit të kryengritjes, dhe nga ana tjetër, për shkak të atij incidenti që ndodhi pak më parë, një orë pasi ai ishte nisur nga manastiri. Po i ngjitej pyllit përpjetë drejt Markiniadhës, kur e rrethoi një kope qensh të egërsuar që lehnin si të tërbuar dhe hoqi të zitë e ullirit derisa u shpëtoi dhe u largua. Pela e tij, Artemisë, pësoi nja dy kafshime dhe ai vetë u detyrua të hidhte dhe të shpërndante përreth të gjitha gjërat me të cilat e kishte furnizuar igumeni - djathëra, bukë, vezë, mish të tymosur, sallame. Qentë iu vërsulën ushqimeve dhe ai u largua me galop në të përpjetë. Ndërkohë, nuk e përjashtonte mundësinë që t'ia prisnin përsëri rrugën, pavarësisht se kishte rreth tri orë që po ecte.

Në lindje, më lart në kodër, u shfaq kisha e shenjtë e Hyjlindësës. Hyjlindësja, siç ishte bërë zakon që t'i thoshin. Më mbrapa në të djathtë, mezi dalloheshin shtëpitë e Petas të ngulura në shpatin shkëmbor, ku kishin ngritur kampin e tyre Kiço Xhavella, Spiro Karaiskaqi, i biri i Jorgos, Zaho Miloja, Pllaputa, Petmezai, Kallamogdharti dhe oficerë të tjerë së bashku me luftëtarët nga Shtatë Ishujt, nga Moreja dhe Rumelia së bashku me kryengritësit e Radhovizit dhe të Xhumerkës. Sa për Kasivakin, Skalcojanin, Cigaridhën, Kondonikën, Kacikojanin dhe krerë të tjerë vendas të kryengritjes, ata kishin zënë pozicione në trajtë perimetri rreth Artës, në Petrovuni dhe përballë lumit Araithos.

Me shpërthimin e kryengritjes në fillim të vitit, të shumë ishishin ata që besuan se këtë herë kishte ardhur momenti që të çlirohej Arta dhe i gjithë Epiri. Shpresat u bënë më të mëdha më 31 janar, kur nëntogeri Spiros Karaiskaqi me luftëtarët e vet pushtuan qytetin dhe mbanin të rrethuar otomanët në kala.

Por në vazhdim, dëbora dhe i ftohti i acartë i detyruan që të ktheheshin në Peta dhe si rezultat, ditëve që pasuan, banorët grekë të qytetit u bënë viktima të dhunës dhe shumë shtëpi u plaçkitën. Kryengritësit i vazhduan betejat dhe të gjithë prisnin që nga dita në ditë të shikonin flamurin grek të valëvitej mbi kala, teksa turqit kishin të paktën pesëqind të vrarë dhe morali i tyre kishte rënë kaq poshtë, saqë kajmakami Setik efendi propozoi që të dorëzoheshin dhe familjet turke të niseshin drejt Janinës.

Megjithëkëtë, kishte pothuajse një muaj e gjysmë që dallohej qartë se patosi i kryengritësve kishte rënë, teksa qëndronin duarkryq dhe të ngulur në Peta. Qarkullonin fjalë për tradhti, për marrëveshje të fshehtë të komandantit të kampit Kiço Xhavella me anglezët dhe me turqit, për grindje midis oficerëve, por edhe për ndërprerje të ndihmës ekonomike nga komisione dhe shoqata të Athinës, ndërkohë që një anije angleze dhe një franceze, që kishin hedhur spirancën në gjirin e Ambrakisë, pengonin kalimin e anijeve për furnizimin e kryengritësve. Cilado që të ishte e vërteta dhe situata në përgjithësi, kriza në radhët e kryengritësve ishte e dukshme. Ishte një fakt i vetëkuptueshëm, ngaqë vetëm një javë më parë, otomanët, të rrethuar dhe nën presion nga mungesa e ushqimeve, tentuan të kundërsulmonin dhe të dilnin deri në kufijtë e Aninës<sup>1</sup> dhe të pashqetësuar plaçkitën dhe u vunë zjarrin tri fshatave. Për banorët e Artës dhe të zonës më gjerë, kjo do të thoshte dhe fundi i kryengritjes. Pashkët që do të vinin pas dy javësh do t'i gjenin përsëri nën zgjedhë, ashtu si tani e katërqind e pesë vjet më parë.

---

<sup>1</sup> Lumë përgjatë kufirit deri në vitin 1881 dhe fshat me pesë a gjashtë shtëpi. Më vonë mori emrin Sikulla.

Otomanët e ngritën flamurin me gjysmëhëne mbi kala më 24 mars 1449 dhe ai vazhdonte të valëvitej mbi Ambrakinë e lashtë tashmë nëntokë, mbi atë qytet me njëzet e pesë mijë banorë të periudhës së artë të mbretit Pirro, mbi Artë, kryeqytetin e Despotatit të Epirit, mbi shpirtrat e skllavëruar të grekëve, të cilët vazhdonin të mbanin në duar fillin e kombit, derisa të bashkoheshin me Greqinë e lirë.

E shkuara, e tashmja dhe e ardhmja ndërthureshin në mendjen e Londos Thersitit, por më tepër i rëndonte në shpirt e tashmja, e cila e ftonte të kthehej sa më parë në shtëpi, dhe tek e shoqja, që ishte gati për të lindur. Llogariste të mbërrinte shumë më shpejt, të mos e zinte as nata, por u vonua të nisej nga manastiri i Mellatëve, ku e çoi besimi i tij dhe dy shtatzënitë e mëparshme të pafata të gruas së tij. Qëllimi i tij ishte t'i falej Shën Mërisë dhe kështu veptoi. T'i lutej për fëmijën që prisnin të lindte që të ishte i shëndetshëm dhe jetëgjatë.

“Do të jetojë!”, tha me vete dhe shtrëngoi në duar ikonën e vogël të gdhendur në dru, dhuratë nga igumeni Genadios. “Është nga Mali i Shenjtë, e skalitur me dorë. Vare te djepi i foshnjës. Ky fëmijë do të jetë nën çatinë dhe nën mbrojtjen e saj. Beso dhe gjithçka do të shkojë siç e dëshiron.” Kështu i tha dhe besimi i tij sa vinte e forcohej, por bashkë me të edhe ankthi, sa më shumë që i afrohej qytetit.

Hyjlindësen dhe Petën tashmë i kishte lënë mbrapa dhe tani ecte në një vend të hapur. Ullishtat alternoheshin me vreshtat dhe thellë, në perëndim, dukeshin herë pas here dritat e zbehta të Artës. Qyteti ngjante me një prej librave që ai preferonte kaq shumë. Edhe pak rrugë dhe do të hapte kapakun e këtij libri, për t'u gjendur në rrugët e tij gjarpëruese, që Londosit i kujtonin çdo gjë, me përjashtim të atij shkrimi si këmbët e pulës. Përkundrazi, në rrugët e ngushta me kalldrëm dhe

plot kthesa, ai dallonte bukurshkrimin më të përkryer dhe një harmoni unike. Përfytyronte madje që pas disa vitesh të ishte duke ecur nëpër to, duke mbajtur dorën e të birit - sepse shpresonte që foshnja që do të lindte do të ishte djalë - dhe t'i tregonte të fshehtat e çdo cepi, çdo ndërtesë, kishe apo xhamie. T'i tregonte edhe rrënojat e Ambrakisë së lashtë, nga periudha e së cilës ai kishte gjetur monedha kur gërmonte për të hapur themelet e shtëpisë së tij, amfora dhe një statujë të plotë të perëndeshës Artemisë. Të perëndeshës, së cilës, siç pretendonte ai, qyteti i Artës i detyrohej emrin e saj.

Në të majtë dalloi varrezat e hebrenjve dhe më larg, në Petrovuni, dalloi masën e përhimët e të vetmuar të kishës Faneromeni, të cilën e kishin pushtuar otomanët që me fillimin e kryengritjes, duke e shndërruar në kamp fushimi. Befas pela filloi të shfrynte e shqetësuar.

- Urtë, Artemisë. Nuk është asgjë... - mermëriti dhe, duke u përkulur, e ledhatoi në qafë. - Ja tek është qyteti ynë. Edhe pak akoma dhe...

Fraza i mbeti në mes. Krisma i ndërpreu dhunshëm fjalët e tij dhe njëkohësisht ndjeu një goditje dhe një djegie të fortë në shpatullën e djathtë. Pela, e trembur, u ngrit duke hingëlluar mbi këmbët e pasme, duke e flakur trupin e tij në ajër nga ku pas pak sekondash u gjend me fytyrë zhytur në shtresën e trashë të pluhurit të rrugës.

I trullosur nga rrëzimi dhe duke rënkuar prej dhimbjeve, u përpoq të ngrihej. Pela, megjithëse u tremb, qëndronte pranë tij dhe godiste tokën me thundrat e saj. Kapi rripat, u ngrit përgjysmë, futi me vështirësi këmbën në yzengji dhe duke u stërmunduar, arriti të kalëronte përsëri. “Paratë!”, i kaloi vetëtimthi ky mendim në kokë, kur e ndjeu që nuk e kishte më trastën në sup. Megjithatë, pa hezituat, ia ngjeshi mamuzet pelës në bark dhe ajo u shkund dhe u hodh përpara me të katra.

Në të majtë të tij dalloi një siluetë të errët mbi shkëmb duke ngritur përsëri pushkën, teksa ai po kalonte rreth dhjetë metra larg.

- I mallkuar! - ulëriti.

Plumbi i dytë e kapi në shpatull. Dhimbja therëse e përshkoi tejpartej dhe trupi i tij filloi të lëkundej rrezikshëm. U përkul, një herë majtas, pastaj djathtas, por ia doli të mbahej mbi shalë dhe të vazhdonte rrugën me galop drejt qytetit.



Sahati i kalasë trokiti duke treguar orën e tretë të natës allaturka, kur Agni Thersiti, duke shtrënguar dhëmbët, po bënte përpjekjet e fundit për të lindur.

- Edhe një herë! Edhe një! Të lumtë! Ja tek është, e dalloj! - dëgjohej zëri hundor i Bolenës, mamisë.

Në të njëjtën dhomë, me ankthin që u dallohej në fytyrë dhe të gatshme për të ndihmuar, qëndronin Fotini Fasganu dhe mikja e Agnisë, Anastasia Megi.

Në oborrit e vilës, ku në qendrën e tij Londos Thersitis vendosi në një piedestal përmendoren e perëndeshës Artemisa të gjetur gjatë gërmimit të themeleve, Dhamianos Megi bënte ecejake i shqetësuar. Duke mos e hequr çibukun nga goja, dëgjonte rënkimet e Agnisë dhe porositë që i jepte Bolena, ndërsa herë pas here përshkonte me hapa të shpejtë rrugicën e gjatë deri te dera e jashtme prej druri. Hapte me kujdes njërin kanat, hidhte vështrimin nga rruga e ngushtë e shtruar me pllaka guri dhe e mbyllte përsëri, duke u kujdesur që për çdo herë të vendoste shulin. Qëndronte aty për një kohë të shkurtër pa lëvizur, ngrinte sytë dhe vështronte murin e lartë që rrethonte nga të gjitha anët vilën dhe pastaj kthehej përsëri në pjesën e pasme të oborrit.

Dhamianos Megi shqetësohej për mikun e tij si dhe për Agninë, e cila ishte e detyruar të lindte pa ndihmën e mjekut, megjithëse kishte abortuar dy herë. Mjeku i saj personal, Krokidha, ashtu si edhe mjekët e tjerë të Artës, së bashku me mjaft banorë të tjerë të kamur, u larguan për në Prevezë me të filluar kryengritja. Shqetësohej edhe për faktin se gjendja e përgjithshme nuk paralajmëronte asgjë të mirë. Në drekë kishin mbërritur në kala, duke kaluar nëpërmjet Sallaorës, një mijë ushtarë turq, në ndihmë të pesë mijë ushtarëve që ishin aty ndërkohë dhe gjithandej qarkullonin fjalë se pritej sulmi kundër kryengritësve në Peta. Ndërkohë, kishte tre muaj që qyteti shkretuhej me të rënë errësira. Kafenetë, pijetoret, tavernat, të gjitha të mbyllura, nëpër rrugë nuk shihej këmbë njeriu. Shumica e banorëve të qytetit, myslimanë dhe hebrenj, i kalonin netët në kala, ose mbylleshin nëpër shtëpitë e tyre. Sa për banorët grekë, shumë strehoheshin në Mitropoli, të cilën e ruante një togë e ushtrisë otomane. Ndërsa shumë banorë u larguan drejt fshatrave malore, apo dhe fushore, para se autoritetet turke të qytetit të ndalonin daljen pa pasur leje të posaçme. Por edhe largimi shpëtonte vetëm ata vetë, përderisa shtëpitë e të gjithë atyre që largoheshin bëheshin pre e plaçkitjes nga ushtarët apo dhe qytetarët fanatikë turq.

- Edhe një herë! - u dëgjua zëri i Bolenës, dhe menjëherë më pas: - Prit, kordoni është mbështjellë rreth qafës së tij!

I shqetësuar, Dhamianos Megi ngjiti menjëherë shkallët. Por duke u ndërgjegjësuar për pafuqinë e tij për të ndihmuar, u ndal te sheshpushimi, siç e quanin atë ambient, të mbuluar nga sipër, por krejt të hapur në drejtim të oborrit. Rreth sheshpushimit, në trajtë II greke rreshtoheshin dhomat. Në të majtë dhe në të djathtë, dhomat e miqve dhe ajo e ndenjjes, në thellësi, dhomat e gjumit, kuzhina, ndërsa në anën e djathtë, në drejtim të rrugës, dhoma me oxhak ku qëndronin gjatë dimrit.

- Unë! Unë me duart e mia, mos u shtrëngo! - mamia i jepte udhëzime Agnisë, dhe pastaj kujdesej të shtonte: - Na ndihmo, o Shën Mëri!

Megi zbriti përsëri në oborrin e shtruar me pllaka. Pemë limoni, portokalli, trëndafila dhe shumë lule të mbjella nëpër lehe anës mureve, shpërndanin në ajër aroma dehëse. Pa vetëdije, i erdhën ndër mend vargjet e këngës që këndonte së bashku me Londosin, herë jashtë shtëpisë së Anastasias, herë të Agnisë, kur të dalldisur prej dashurisë, nuk u shqiteshin dy mikeshave:

*Ashtu siç na vjen prilli/ ashtu do të vij dhe unë/ të puthurën në dy buzët e tua/ pikë-pikë unë do ta thith.*

Një buzëqeshje e zbehtë ia përshkoi fytyrën, para se t'i drejtohej përsëri derës së jashtme të vilës. Rruga ishte përsëri e shkretë. Londos Thersiti nuk dukej asgjëkund dhe ai tashmë filloi të shqetësohej për më të keqen. Hodhi përsëri një vështrim. Asgjë. Nga shtëpia përballë, pranë rrënojave të kishës së Shën Llukës, dëgjoheshin biseda dhe ishin ndezur shumë drita.

- Turqit e dreqit! Pillni sikur të ishit lepuj, - shqiptoi me zë të ulët.

Më në perëndim ishte edhe një shtëpi tjetër myslimanësh, më e vogël, dhe në atë orë e pandriçar. Vila e Thersitit ishte ndërtuar pikërisht në kufijtë e lagjeve të Shën Theodorës, në të cilën banonin grekë, dhe të Sulltan Bajazitit apo Pazarit Turk, ku banonin kryesisht turq dhe ku kishin edhe dyqanet e tyre. Përkundrazi, vila e tregtarit të madh dhe pronarit Dhamianos Megi ndodhej në lagjen e pasur greke të Shën Minait, afër nënkonsullatës greke.

- Dhamian! - e thirri e shoqja dhe ai nxitoi të kthehej në oborr.



- Djalë! - i thirri ajo e gëzuar, nga sheshpushimi. - Një djalë shumë i bukur biond!



Te shtëpia dykatëshe përballë, në odën e burrave, të cilës turqit i thoshin *selamllëk*, Jashari me të vëllain po çlodheshin ulur nëpër mindere duke thithur çibukët e tyre, ndërsa i ati i tyre, Ismaili, po thithte nargjilenë.

Nilgjuni, vajza katërvjeçare e Jasharit, dhe Behzati, djali i tij trevjeçar, herë vraponin lart e poshtë dhe herë shtriheshin nëpër sixhadetë e trasha me motive të Lindjes. Përkundrazi, djali tjetër i tij, Dogani shtatëvjeçar, qëndronte serioz pranë xhaxhait të tij, Mehmetit.

Nëse do të hiqnim nga ajo hapësirë minderet, sixhadetë dhe nargjilenë e Ismail beut, nuk mbetej asgjë që të të kujtonte Lindjen. Tavolinat, kolltukët, ndenjëset, vazot dhe gjithçka tjetër që gjendej në dhomë, ishin sjellë nga Parisi, Londra apo Venecia. Sa për emërtimin *selamllëk*, i kishte mbetur vetëm emri, si fjalë dhe jo në përmbajtje, përderisa shumë prej stereotipave të së kaluarës ishin zhdukur me kohë.

*Selamllëku*, i cili zinte vendin kryesor në qendër të katit, lidhej me dhoma të veçanta pa korridore ndërmjet tyre. Në *heremllëk*<sup>1</sup> po lindte Safija, bashkëshortja e Jasharit. Bisedat e grave dhe udhëzimet që jepte mamia dëgjoheshin deri te *selamllëku*, derisa e qara e një foshnje vërtetoi që lindja kishte pasur një fund të lumtur.

- Djalë! - solli lajmin gjyshe Selmaja.

---

<sup>1</sup> Oda e grave te myslimanët.

Jashari u ngrit, i puthi dorën së ëmës dhe u fut në dhomën që ndodhej Safija, motra e saj, mamia, shërbëtorja Fatma dhe foshnja e porsalindur. Pas pak u kthye.

- Nexhip, - tha gjysh Ismaili, - Nexhip t'ia vini emrin, siç e kishte dhe im vëlla.

- Që të ketë fatin e tij? - iu kundërpërgjigj Jashari.

- Ishte hero! - protestoi gjyshi Ismail për vëllain më të vogël, që ishte vrarë gjatë sulmeve të grekëve për pushtimin e kalasë, në betejën e Artës në vitin 1821. - Hero! - tha përsëri dhe shtoi, thua se po parashikonte të ardhmen: - Fatin do ta ketë të mirë.

- Allah versin!<sup>1</sup> - uroi Jashari, pa sjellë kundërshtime të tjera për emrin e të porsalindurit.

- As saze dhe as këngë, - hungëriti Mehmeti. - Po jua them, u erdhi fundi kaurëve. Një apo dy ditë akoma dhe gjaku i tyre do të skuqë dheun. Dhe atëherë do të bëjmë aheng të dyfishtë!

- Jahve,<sup>2</sup> Nexhip! - uroi Jashari dhe ngriti gotën me raki në drejtim të dhomës ku dëgjoheshin të qarat e djalit të tij të tretë.

- Jahve! - përsëriti gjyshi Ismail dhe pastaj Mehmeti.

- Jahve! Jahve! - thirrën edhe dy fëmijët e vegjël, Nilgjuni dhe Behzati, ndërsa Dogani qëndronte fytyrëngrysur dhe pa folur në ndenjësë.



Patkonjtë e Artemisës trokëllinin në rrugën e shtruar me pllaka guri të Romiopazaros, pazarit të të krishterëve. Me hap të ngadaltë, sikur po ndiqte një procesion mortor. Londos

<sup>1</sup> Allahu qoftë me të.

<sup>2</sup> Për shëndetin tënd (dolloi).

Thersitis, me pjesën e sipërme të trupit mbështetur mbi qafën e pelës, mezi arrinte të mbahej mbi shalë dhe të mos rrëzohej. Rënkonte, merrte frymë me vështirësi dhe fliste përçart:

- Fëmija... ikona... Agnia... paratë...

- Më qëlluan... - arriti t'u belbëzonte pak më parë ushtarëve turq në postën turke në Agios Theodoros.

- Lejen! - këmbëngulte me një fytyrë që nuk shprehte asgjë çaushi që ishte në krye të njësisë, duke i kërkuar lejen e daljes. Me duart që i dridheshin dhe gati duke u rrëzuar nga pela, ai kërkoi në xhep lejen që kishte marrë nga komandanti ushtarak, të cilën e siguroi pas ndërhyrjes së Jashar Efendiut. Kapiteni i hodhi një sy letrës duke e ndriçuar me fenerin që mbante në dorë dhe ia ktheu.

- Jepi! - i tha ftohtë dhe u kthye pranë zjarrit ku nja katër a pesë ushtarë po pinin raki, bënin shaka mes tyre dhe qeshnin me zë të lartë.

E quajti të kotë t'u kërkonte që ta ndihmonin. I mbytur në gjak dhe me fuqitë që po e lëshonin, vazhdoi rrugën. Kaloi Shën Markun dhe me pelën që ecte ngadalë, po vazhdonte në rrugën kryesore që i thoshin Romiopazaro, sepse te kjo rrugë i kishin dyqanet e tyre shumica e grekëve të krishterë.

Kur arriti afër xhamisë së Kiliç beut, rreth pesëdhjetë metra larg kishës së Shën Georgios, një re e zezë mbuloi hënën dhe kudo ra një errësi e thellë. Vetëm, herë-herë, kur i afrohej ndonjërit prej fenerëve të rrallë, vendi ndriçohej për pesë apo për dhjetë metra dhe pastaj pela së bashku me kalorësin humbitnin, thua se i kishte përpirë nata.

Pela ecte me ngadalë në mes të rrugës së shtruar me pllaka, sikur e ndiente gjendjen e të zotit. Ndërkaq, në fund të sheshit të vogël "Monoplio", u pengua në një prej urave të vogla prej druri që ndërprisnin në disa pika Romiopazon dhe si për mrekulli Londos Thersitis nuk u plas përtokë.

- Në shtëpi... të arrij në shtëpi... - përsëriste me mundim, thua se këto fjalë i jepnin kurajë.

Qyteti i boshatisur, i shkretë. Te kisha e Shën Dhimitrit mori drejtimin për nga veriu, drejt kishës së Shën Minasë, ku ndodheshin shtëpitë e grekëve. Edhe aty shtëpitë ishin të mbyllura dhe të zhytura në errësirë. Këmbë njeriu s'kishte, asnjë dritë, nuk dëgjohej asnjë bisedë. Në errësirë të plotë ishte dhe kafe "Aman" pak më poshtë, teksa pela mori drejtimin për në perëndim. Në kohëra të tjera, në këtë orë, do të dëgjohej muzikë, këngë, njerëz që do të lëviznin lart e poshtë.

Po merrte frymë me vështirësi. Nuk fliste më përçart. Vila e tij ishte e shumta njëqind metra larg. Pemët e limonit dhe të portokallit mbrapa kangjellave të punuara me art të kopshtit të kafe "Aman", nuk kishin gjetur njeriun e duhur për t'i përcjellë mesazhin e ardhjes së prillit. Dhe për çudi, nuk mbante mend që t'i kishte ndier më të forta dhe më të ëmbla aromat e luleve të tyre të para.



- Flini këtu sonte, - i propozoi Jashari vëllait dhe gruas së tij.

- E kanë bërë në brekë sonte kaurët, nuk ka rrezik. Do të shkojmë në shtëpi, - tha Mehmeti.

Gruaja e tij do të kishte preferuar të qëndronte, por nuk guxoi të kundërshtonte.

- Do të shkoj edhe unë me amxha<sup>1</sup> Mehmetin, - u hodh e tha Dogani, dhe duke vrapuar për në thellësi të dhomës, solli

---

<sup>1</sup> Xhaxha nga babai.

shpatën e tij prej druri, dhuratë e xhaxhait të tij. - Dhe kushdo prej të pabesëve që të guxojë, do t'ia heq kokën! - kërcënoi ai dhe e tundte shpatën në ajër.

Jashari ishte gati të mos e lejonte, por ndërhyri Mehmeti.

- Lëre! Do të kujdesem unë për të!

Mehmeti, që nuk kishte për vete fëmijë, në njëfarë mënyre kishte birësuar Doganin, mamaja e të cilit dhe gruaja e parë e Jasharit kishte vdekur një vit pasi kishte lindur djalin.

- Po zbres bashkë me ju, - u mjaftua të thoshte Jashari, ndërsa nga minderi ku ishte ulur, gjyshi Ismail, si të qe ndonjë profet, bëri këtë parashikim:

- Ujku, këlysh ujqërish do të rrisë.

Në fund të shkallëve, u ndanë. Mehmeti, së bashku me gruan e tij dhe Doganin, u drejtua për nga dera e oborrit, ndërsa Jashari shkoi në thellësi të kopshtit të madh ku ndodheshin stallat dhe nja dhjetë kuaj. Kur po afrohej, ia behu papritur përpara shërbëtori i tij, Fuati, nga dhoma ngjitur.

- Efendi! - i tha dhe dukej që sapo ishte zgjuar nga gjumi.

- Gjithçka në rregull, Fuat, po u hedh një sy, - tha Jashari, por në fakt po priste që të largohej Mehmeti, që të shkonte dhe të trokiste te dera e Thersitit përballë. Të mësonte sesi ishte Agnia që po lindte, ngaqë të dyja familjet kishin marrëdhënie të ngushta. Arsyeja që po shkonte pothuajse fshehurazi, ishte se nuk kishte guximin, por as dëshirën, që ta hapte këtë bisedë me Mehmetin, i cili i kritikonte vazhdimisht miqësitë që i vëllai kishte me të krishterët.

- Po hanëm Safija? - pyeti Fuati, dhe kur hëna u shfaq përsëri midis reve, dallohej që kishte një gungë të madhe në kurriz.

- Lindi, bëri djalë! - iu përgjigj Jashari.

- Të rrojë! Allah versin! - e uroi Fuati dhe po në atë moment u dëgjua zëri i çjerrë i Doganit nga rruga.

- Një i vdekur!

Po në atë moment Mehmeti po hapte me vrull derën dhe po futej në oborr.

- Fqinji yt! - i thirri Jasharit, i cili po mbërrinte duke vrapuar.

Në rrugën e ngushtë të shtruar me gurë, Londos Thersitis po dergjej pak metra larg shtëpisë së tij ndërsa pranë i qëndronte pela.

Mehmeti ndriçoi trupin që nuk lëvizte me fenerin e tij, ndërsa Dogani u afrua me fenerin e vet dhe po kontrollonte me sy burrin që dergjej në tokë.

Jashari u përkul mbi të.

- Nuk merr frymë... - foli i tronditur dhe filloi të trokiste me forcë në derën e oborrit të shtëpisë së Londosit.

- Lëre aty ku është! - i kërkoi Mehmeti, por duke parë që fjalët e tij nuk po jepnin rezultat, hoqi dorë. Tërhoqi gruan e tij që po qëndronte mënjanë duke u dridhur, i vuri dorën në sup në mënyrë inkurajuese Doganit, që nuk po i shqiste sytë nga trupi i të vdekurit dhe me hap të shpejtë iu drejtuan lagjes “Elijazbeu”.



Varrimi i Londos Thersitit u bë të nesërmen pasdite në oborrin e kishës së Shën Dhimitrit, ngaqë të krishterët i varrosnit njerëzit e tyre në oborret e kishave dhe tek ato që dispononin hapësirën e duhur.

Kambana e Shën Dhimitrit mbeti e heshtur në kambanoren e saj të thjeshtë. Otomanët, për shkak të paragjytimeve të tyre, ua ndalonin kishave që kambanat të kumbonin përvajshëm, natyrisht, aty ku lejonin që këto kisha të funksiononin. Ndërkohë, tinguj të tjerë, krismat e betejës që mbërrinin nga

drejtimi i Petës, e shoqëruan Londos Thersitin në banesën e tij të fundit. Orët e para të mëngjesit, grupi i kryengritësve nga Peloponezi, duke i dhënë në mënyrë të njëanshme fund asaj gjendjeje mosveprimi, iu afrua hyrjes së qytetit të Artës dhe sulmoi postblloqet turke. Por në vazhdim dhe pas refuzimit të komandantit të kampit të fushimit, Xhavellës, që t'u çonte përforcime, u detyruan të tërhiqen. Turqit kundërsulmuan me dy mijë ushtarë dhe tani beteja po zhvillohej në rrëzë të malit të Petës.

Pas këtyre zhvillimeve, të paktë ishin ata që ndoqën kortezhin mortor, ndërkohë që lëvizje nervoze, ecje me hap të shpejtë dhe një shqetësim që nuk fshihej, mbizotëruan gjatë gjithë rrugës deri te varrezat.

Agni Thersiti këmbënguli që të merrte pjesë në varrimin e të shoqit. Duke u mbajtur prej Anastasisë dhe Dhamiano Megit, arriti deri te kisha dhe humbi ndjenjat gjatë ceremoninë mortore, kështu që çifitit Megi iu desh që ta kthenin urgjentisht në shtëpi. Bashkë me ta u larguan dhe Jashari me Ismailin, të cilët ndoqën kortezhin mortor, por qëndruan jashtë oborrit të kishës.

Të tjerët pritën derisa arkivoli të futej në varr, hodhën sipas zakonit pak dhé tek i vdekuri dhe nxituan të largoheshin. Pak guximtarë qëndruan dhe pritën derisa varri të mbulohej, kryesisht miq të ngushtë të të vdekurit, teksa familja e Londos Thersitit, me përjashtim të dy kushërirave të tij, nuk kishte të afërt të tjerë të gjallë. Vëllezërit, prindërit, xhaxhallarët, gratë e tyre i kositi kolera e vitit 1848, së bashku me qindra banorë të tjerë të Artës dhe të rajonit përreth.

Midis atyre të paktëve që qëndruan, ishte dhe Sotiris Fasganos, fqinj i familjes dhe vëlla i Fotinisë, e cila kujdesej për të porsalindurin në vilë.

- Çfarë fatkeqësie! Të vritet në momentin e lindjes së të birit! - tha ai.

- Po ata të dy kush ishin? - pyeti Tabaki, që tani së fundmi ishte vendosur në qytet dhe merrej me importimin e mallrave të çdo lloji.

- Iltizamzi Jashar efendi, akaparuesi i taksave, së bashku me të atin, Ismail beun, - iu përgjigj Vasillakopullosi.

- Turqit e vranë, - konkludoi Fasganosi.

- Nëse do të kishin qenë turq, përse e lejuan të kalonte në postbllok? - e kundërshtoi Maleni, tregtar pëlhurash dhe koleg i Londos Thersitit.

- Sipas të gjitha gjasave, kanë qenë banditë, dhe duhet të kenë qenë larg kur e qëlluan, - shprehu mendimin e tij mësuesi, Dhimopullosi, dhe shtoi: - Mjeku ushtarak konkludoi se vdekja i erdhi si rezultat i hemorragjisë që nuk pushonte.

- Po banditët do ta kishin lejuar që të kalonte? - këmbënguli Fasganosi.

- Ia morën ato që deshën, në trup nuk iu gjet asgjë, - tha Derdeni.

- E ka parë njeri Krokallon? - u fut në diskutim edhe Lema, një tip që mund ta gjeje kudo, dinte gjithçka për gjithkënd, merrej me jetën private të të tjerëve dhe përhapte lloj-lloj fjalësh.

Askush nuk iu përgjigj, thua se nuk e kishin dëgjuar.

- Kishin kontradikta me të ndjerin... - vazhdoi ai. - Fqinjë ishin, shtëpitë ngjitur me njëra-tjetrën dhe nuk i erdhi as në varrim!

Përsëri nuk iu përgjigj njeri. Krismat e armëve vazhdonin të vinin në mënyrë sporadike nga ana e Petas. Dy varrmihësit mbaruan punë dhe u larguan. Në rrugën e Romiopazaros, më të rrallë dukej ndonjë kalimtar që ecte me nxitim, megjithëse



dyqanet ishin të gjitha të hapura. Sipas urdhrit që kishte dhënë administrata turke, ai që e mbyllte dyqanin para se të errej, do të konsiderohej bashkëpunëtor i kryengritësve dhe do të shkonte në burg.

- Të rrojmë vetë, - foli i pari Tabaki, dhe sikur të kishin pritur të gjithë këtë sinjal, u shpërndanë njëri pas tjetrit.



Në të gdhirë të 13 prillit, gjashtë mijë ushtarë otomanë, nën komandën e shqiptarit Çelo Picari dhe të drejtuar nga konsulli anglez në Prevezë, Sonders, sulmuan gjashtëqind kryengritësit në Peta. Këta të fundit, me pozita të dobësuara pas largimit natën të Kiço Xhavellës dhe burrave që ai komandonte drejt territorit të Greqisë së lirë, bënë rezistencë të dëshpëruar. Artileria e otomanëve mbillte vdekjen në radhët e luftëtarëve grekë dhe zhurma e predhave u copëtonte zemrën banorëve të krishterë të Artës.

Beteja vazhdoi rreth gjysmë ore. Shiu i vazhdueshëm, i cili nxori jashtë loje armët e vjetra të kryengritësve grekë, dhe superioriteti i dukshëm numerik i turqve, përcaktuan fundin e betejës. Së bashku me betejën e humbur, u shuan edhe shpresat e atyre që ëndërronin ta shikonin qytetin e tyre të çliruar, ndërsa Petës iu vu zjarri, banorët e tij u dëbuan dhe për dy vitet pasardhëse fshati do të mbetej i pabanuar.

Shiu vazhdonte të binte kur Safija trokiti me forcë në derën e oborrit të vilës së Thersitit. Sahati i kalasë me tingullin e vet shënonte orën e dytë otomane të ditës dhe vetëm pak më përpara kishin pushuar dhe krismat që vinin nga beteja në Peta.

Derën ia hapi Dhamianos Megi dhe i tha që foshnja kishte qarë gjithë natën. I tha gjithashtu se duke mos pasur alternativë

tjetër, po bëheshin gati ta çonin në spitalin ushtarak otoman në Shën Theodhora, por nuk dinin sesi do t'i trajtonin, meqenëse ishte spital ushtarak dhe nuk parashikohej trajtimi i civilëve.

- Spitali u mbush me ushtarë të plagosur, - vetëm kaq tha Safija dhe u ngjit me të shpejtë shkallëve.

Duke u futur në dhomë, ngushëlloi Agninë e cila ngjante si kufomë e gjallë. Ishte bërë hije e vetvetes. Sikur të mos mjaftonte vdekja e të shoqit, tani u shtua dhe problemi i shëndetit të foshnjës, duke e futur në dëshpërim të thellë.

Foshnja qante me të madhe dhe nëna e tij, e tmerruar, sillej lart e poshtë me atë në krahë, me shpresë se do të qetësohej. Por Safija, sapo hyri vuri re që foshnja duke qarë, fuste në gojë gishtin e saj.

- I dhe për të pirë? - e pyeti.

- Sigurisht, se mos bëj ndonjë tjetër! Por nuk po e lënë dhimbjet, - iu përgjigj Agnia.

- Po si mund të rrinte pa i dhënë gj? - u hodh menjëherë dhe Anastasia.

Safija nuk ia vuri veshin, ngaqë Anastasia nuk kishte fëmijë vetë, rrjedhimisht, nuk kishte as përvojë.

- Më lër të të shoh pak gjirin, - i tha Agnisë dhe i hodhi një vështrim kuptimplotë Dhamiano Megit, i cili doli menjëherë nga dhoma.

Agnia e vështronte me dyshim, por Safija nuk i la rrugëdalje tjetër. Ia mori foshnjën nga krahët, ia dha Anastasisë, i tha Agnisë të ulej dhe filloi që t'i zbërthente kopsat. Në vazhdim, filloi t'i shtypte herë njërin, herë tjetrin.

- Moj, po ti nuk ke qumësht! Të është shterrur qumështi!

Agninë e zuri paniku dhe përpiquej me ankth duke i shtypur me gishtërinj thithkat e saj që të fillonte të rridhte qumështi.

- Ngadalë, do t'i lëndosh! - ngriti zërin Anastasia.

- E për çfarë më duhen? Çfarë të bëj me to tani? - bërtiti ajo dhe ia shkrepiti të qarit.

Safija ia rrëmbeu foshnjën Anastasisë nga duart, u ul në kolltuk dhe nxori gjinj të e saj të bardhë dhe të fryrë. Foshnja ngjiti buzët aty, pushoi së qari dhe pinte si i babëzitur.

- Shiko, ore kiuçuk!<sup>1</sup> Bre kiuçuk! - foli me zë të butë Safija dhe i përkëdhelte pjesën e prapme të kokës.

Dukej qartazi se Anastasia Megi nuk ishte dakord me këtë veprim. E aq më tepër i shoqi, Dhamianos Megi, kur ta merrte vesh. Djalit që ata do të pagëzonin t'i jepte gjë një turkeshë! Kjo nuk kishte kuptim! Por ndërkohë, duke parë që Agnia u çel në fytyrë, arriti ta përmbajë karakterin e saj zakonisht të rrëmbyer.

- Si do t'ia vësh emrin kur ta pagëzoni? - pyeti Safija dhe Agnia ktheu kokën në drejtim të Anastasisë.

- Është shpejt akoma, - u përgjigj ajo fytyrëngrysur. - Kemi kohë.

Agnia vështroi kolltukun ku e kishte zakon të ulej i shoqi netëve, në krah të oxhakut të lartë, dhe pastaj vështrimi i saj u end nëpër dhomë. U ndal te dollapët e bukur venecianë, te kanapetë mbuluar me velenxa, te tavolina e shkrimit me dru arre, te ndenjëset me lustër dhe përsëri te kolltuku ku rrinte i shoqi.

- Londos... - pëshpëriti dhe vazhdoi të vështrojë kolltukun bosh, a thua se ato dy rrokjet e emrit të tij do të mund të mbushnin atë boshllëk.

- Londos! - tha përsëri. - Do t'i vëmë emrin e burrit tim!

---

<sup>1</sup> Vogëlush, foshnjë.

## *Rrëfimi i Londosit*

**N**ë atë periudhë, në Arta, nuk kishte grua të dytë si nëna ime, Agnia. Pas vrasjes së babait tim, të gjitha përgjegjësitë ranë mbi të dhe i duhej të zgjidhte. Ose do të ndiqte ritmin e jetës, ose do të lejonte vdekjen që ta kishte nëpër këmbë dhe në këtë rast do të fundoseshim të dy.

Zgjodhi jetën për gjithçka që kishte të bënte me anën profesionale dhe me të ardhmen time. Por për sa i përket jetës së saj personale, ajo u shua së bashku me burrin që dashuroi. “Jetën time e mori prilli dhe fluturoi”, thoshte. Ndërsa herë të tjera shprehej: “Unë jetoj me prillin tim, nuk ka rëndësi se nuk e kuptojnë të tjerët.”. Kur u vra im atë, ajo ishte vetëm njëzet e pesë vjeçe.

Menjëherë u vu para dilemës: Do t’ia dilte ta mbante dyqanin e pëlhurave, apo do të duhej ta shiste? Të gjithë, miq dhe të njohur, i propozuan të dytën. “E çfarë mund të bënte një grua vetëm?” Në rastin më të mirë, e këshillonin ta jepte me qira dhe të jetonim me të ardhurat që do të siguronim prej saj. Të shiste edhe vilën dhe të blinim një shtëpi tjetër, më të vogël, dhe të na mbetej diferenca.

E vetmja që e inkurajoi të merrte përsipër përgjegjësinë e menaxhimit të dyqanit ishte mikja e saj dhe kumbara ime, Anastasia.

Përkundrazi, kumbari im, Dhamianos Megi, mendonte se zgjidhja më e mirë ishte që dyqanin ta lëshonim me qira dhe vilën ta shisnim.

Por në fund, për habi të të gjithëve, madje edhe të Anastasisë, nëna ime vendosi të mos e shiste vilën dhe të punonte vetë në dyqan. Ia kishte mësuar në njëfarë mënyre punën im atë dhe ndihej e aftë se do t'ia dilte mbanë. Ai, me durim por edhe me këmbëngulje, i mësoi shkrim e lexim, saqë dy vitet e fundit ajo ishte në gjendje që të mbante librat e llogarisë, ndërkohë që jepte mendime të pjekura edhe për porositë e reja.

Sipas mendimit të përgjithshëm, nëna ime ishte një grua e bukur. Dhe kjo gjë, disa herë, ishte si një dhuratë hyjnore, por herë të tjera veçse ishte si një mallkim, sepse nxiste rivalitetet dhe smirën. Për shkak të profesionit, por edhe të pikëpamjeve të saj estetike dhe të karakterit të saj të fortë, ajo vishej sipas modës së fundit. Përruronte e para çdo shfaqje të modës së re dhe furnizohej me modelet më të fundit të rrobave që tregtoheshin në Paris, në Venecia dhe në Athinë. Në këto përpjekje dhe në zbatimin e ideve të saj, aleate dhe mbështetëse kishte Anastasinë, e cila e konkurronte në bukuri dhe sjellje mondane. Ajo i siguronte ftesa për çdo festë që organizonte klasa e pasur e Artës, e cila ishte e konsiderueshme në numër. Por ajo pranonte vetëm ato ftesa ku shte i pranishëm dhe çifti Megi. Objektivi? Të reklamonte rrobat e reja te zonjat e pasura dhe t'i bënte kliente të saj, ose për blerje copash, ose për blerje rrobash të gatshme europiane, të cilat i importonte e para në qytet.

Në fakt, nëna ime kishte dy fytyra. Agnia e dyqanit tregtar dhe e salloneve mondane, dhe Agnia brenda vilës së saj,

ku jetonte me kujtimet e së kaluarës. Por si në rastin e parë, ashtu edhe në të dytin, ajo mbetej njëlloj e dëlirë, ashtu siç e tregonte dhe emri, Agni - Dlirësi.

Por ndërkohë nuk mundi t'u shpëtonte shpifjeve. Shoqëria në atë qytet të vogël nuk mund të duronte një grua të ve aktive, dinamike dhe njëkohësisht të bukur. Konservatorizmi dhe tendenca për thashetheme si një formë argëtimi, ishin arsyet më të mira për përhapje fjalësh në lidhje me integritetin e saj moral. Për thashethemet më të turpshme, rol të madh luante konkurrenca profesionale e gjoja kolegëve, por edhe keqdashja e një pjese të admiruesve të saj.

Pak muaj pas vdekjes së tim ati, filluan të vinin shumë si të interesuar gjoja për blerjen e dyqanit. Në realitet, synonin të prenotonin, si të dashur potencialë apo dhe si bashkëshortë të ligjshëm, gjysmën e zemrës dhe të krevatit të saj. Me nënkuptime apo dhe me propozime të drejtpërdrejta, synonin ta bënë të tyren, por pa mundur askush të siguronte pëlqimin e saj të lakmuar. Rezultati? Të tërhiqeshin me egoizmin e tyre të lënduar, dhe disa prej tyre arrinin deri aty sa, refuzimin prej saj t'ia faturonin ekzistencës së dashnorëve të tjerë, duke njollosur në këtë mënyrë emrin e saj.

Një prej mëtuesve më këmbëngulës dhe që ushtronte më shumë presion ishte Fasganosi. Duke qenë fqinj - dy shtëpitë tona i ndante vetëm ajo e Krokallos - shfrytëzoi miqësinë e vjetër që kishte me tim atë si dhe marrëdhëniet që Agnia kishte me motrën e tij, Fotininë, dhe na vinte shpesh për vizitë. Por atë darkë që nëna e dëboi përfundimisht nga shtëpia, ai tregoi fytyrën e tij të vërtetë dhe njëkohësisht, unë zbulova shumë prej të vërtetave që nuk i njihja.

Në atë periudhë unë isha shtatë vjeç dhe nga dhoma ime u bëra dëshmitar okular i diskutimit që patën. Nëna ime e priti